



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në mbështetje të nenit 7, paragrafit 1 dhe nënparagrafëve 1.25 dhe 1.31 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 26 qershor 2023, miraton këtë:

RREGULLORE Nr. 01/2023
PËR KOMISIONIN KËSHILLËDHËNËS PËR ETIKËN E PROKURORËVE

Neni 1
Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen rregullat për themelimin, përbërjen dhe procedurën e përzgjedhjes, detyrat dhe përgjegjësitë, si dhe funksionimi i Komisionit Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga Komisioni Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve dhe vlejnë për të gjithë prokurorët e shtetit.

Neni 3
Përkufizimet

1. Përkufizimet dhe shkurtesat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **Komisioni** – nënkupton Komisionin Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve.
 - 1.2. **Kodi i Etikës** - nënkupton Kodin e Etikës Profesionale për Prokurorë.
 - 1.3. **Ligji** - nënkupton Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
 - 1.4. **Këshilli** – nënkupton Këshillin Prokurorial të Kosovës.
 - 1.5. **ZKPSH**- nënkupton Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 4

Parimet e punës së Komisionit

1. Komisioni në punën e tij bazohet në parimet si në vijim:
 - 1.1. **Parimi i ligjshmërisë** - Komisioni gjatë dhënies së opinioneve bazohet në Kushtetutë, në standardet ndërkombëtare, në rregullat e përcaktuara nga praktikat e mëparshme dhe në legjislacionin në fuqi.
 - 1.2. **Parimi i paanshmërisë dhe i pavarësisë** - anëtarët e Komisionit gjatë ushtrimit të funksionit të tyre janë të pavarur, të paanshëm dhe të pandikuar në çfarëdo mënyre.
 - 1.3. **Parimi i ruajtjes së fshehtësisë zyrtare** - nënkupton që anëtarët e Komisionit kanë për obligim ta ruajnë emrin e parashtruesit të kërkesës, i cili ka bërë kërkesë për dhënie të opinionit këshillëdhënës të etikës.
 - 1.4. **Parimet i transparencës** – nënkupton që opinionet e Komisionit janë publike.

Neni 5

Roli i Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë dhënien e opinioneve të qëndrueshme për prokurorë lidhur me pyetjet apo dilemat etike.
2. Puna e Komisionit dhe procesi disiplinor janë të ndara dhe të pavarura nga njëra-tjetra. Opinioneve të Komisionit jepen lidhur me situatat apo sjelljet e ardhshme, të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës, për dallim nga procesi disiplinor, në të cilin përfshihen hetimet dhe seancat e mundshme që shqyrtojnë dhe zgjidhin ankesa për sjelljet e pretenduara joetike të prokurorëve në të kaluarën.
3. Opinioneve të Komisionit nuk janë obliguese, por mund të merren parasysh për përcaktimin e shkallës së përgjegjësisë për shkeljet etike.

Neni 6

Përbërja dhe mandati i anëtarëve të Komisionit

1. Prokurorët që do të shërbejnë në Komision zgjidhen nga Këshilli.
2. Komisioni përbëhet prej tre (3) anëtarësh, dy (2) prej të cilëve propozohen nga ZKPSH-ja dhe një (1) anëtar propozohet nga Prokuroria e Apelit, kurse dy anëtarët rezervë propozohen: një (1) nga ZKPSH-ja dhe një (1) nga Prokuroria e Apelit.
3. Kryetari i Komisionit caktohet me vendim të Këshillit, nga radhët e prokurorëve të ZKPSH-së.
4. Këshilli, për aq sa është e mundshme, ka parasysh përbërjen gjinore të Komisionit.

5. Anëtarët për të shërbyer në këtë Komision duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
 - 5.1. të kenë reputacion të lartë profesional;
 - 5.2. të kenë integritet të lartë moral dhe etikë profesionale;
 - 5.3. të mos jetë aktualisht subjekt i një hetimi disiplinor dhe
 - 5.4. të mos kenë të shqiptuar sanksion disiplinor gjatë pesë (5) vjetëve të fundit.
6. Anëtarët e Këshillit, kryeprokurorët dhe prokurorët që shërbejnë në panel hetimor nuk mund të jenë anëtarë të këtij Komisioni.
7. Nëse eventalisht ndonjëri nga prokurorët që shërben në panel hetimor zgjidhet anëtar i këtij Komisioni, ai/ajo duhet të largohet nga lista e paneleve hetimore.
8. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e Komisionit, gjatë kohës që shërben si anëtar nuk është në pajtim me kriteret e parapara me këtë nen, Këshilli do të pezullojë, respektivisht, do të pushojë mandatin e atij anëtari, sipas të njëjtës procedurë të përzgjedhjes.
9. Prokurorët që caktohen si anëtarë të Komisionit kanë për obligim që të jenë në dispozicion për të shërbyer në Komision për punën e tyre si prokuror, kurse mungesën e tyre gjatë angazhimit të tyre në Komision e koordinojnë me kryeprokurorët e prokurorive përkatëse.
10. Mandati i anëtarëve të këtij Komisionit është tre (3) vjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

Neni 7

Detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të Komisionit

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të Komisionit janë si në vijim:
 - 1.1. thërret dhe udhëheq takimet e Komisionit;
 - 1.2. me kërkesë të Këshillit, përgatitë dhe paraqet raport për punën e Komisionit;
 - 1.3. përfaqëson Komisionin në takime të ndryshme dhe
 - 1.4. pas votimit nga Komisioni, përgatitë dhe nënshkruan opinionin.

Neni 8

Parashtruesi i kërkesës

1. Komisionit mund t'i drejtohen kërkesat për dhënien e opinioneve lidhur me situatat apo sjelljet që mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës, si në vijim, nga:
 - 1.1. Këshilli Prokurorial dhe trupat e tij;
 - 1.2. kryeprokurorët dhe
 - 1.3. prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorive.

2. Për secilën kërkesë të pranuar, stafi mbështetës e njofton kryetarin e Komisionit dhe në bashkëpunim caktojnë takimin për shqyrtimin e kërkesës.
3. Mënyra e parashtrimit të kërkesës për dhënien e opinionit bëhet me shkrim.

Neni 9

Procedura për dhënien e opinionit

1. Komisioni mund të refuzojë kërkesën për dhënien e opinionit këshillëdhënës nëse konstaton se:
 - 1.1. kërkesa është e pabazuar dhe
 - 1.2. kërkesa është paraqitur në lidhje me sjelljet e pretenduara joetike të prokurorëve, të cilat trajtohen sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë.
2. Komisioni mund të kërkojë informacione dhe sqarime plotësuese nga parashtruesi i kërkesës, nëse e njëjta është jo e plotë apo e paqartë, kurse parashtruesi është i obliguar që të veprojë brenda afatit prej 5 (pesë) ditësh nga njoftimi.
3. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk vepron brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, Komisioni e hedh poshtë kërkesën e parashtruesit.
4. Komisioni nxjerr opinion jo me vonë sesa 30 ditë nga dita e pranimit të kërkesës.

Neni 10

Mbështetja administrative

1. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit cakton stafin e nevojshëm mbështetës për t'i ndihmuar në aspektin administrativ.
2. Komisioni duhet të posedojë një e-mail zyrtar dhe një hapësirë të veçantë në faqen zyrtare të Këshillit për publikimin e opinioneve.
3. Stafi mbështetës do t'i njoftojë të gjitha prokuroritë, kryeprokurorët dhe prokurorët në lidhje me adresën elektronike, ku mund të dërgojnë kërkesa për dhënien e opinioneve nga Komisioni.

Neni 11

Opinionet me vetiniciativë

Komisioni mund të nxjerrë opinion këshillëdhënës me vetiniciativë për çështjet me interes të përgjithshëm për etikën për prokurorë.

Neni 12

Takimet e Komisionit

1. Takimet e Komisionit udhëhiqen nga kryetari i Komisionit. Në mungesë të kryetarit të Komisionit, takimi udhëhiqet nga anëtari me nivelin hierarkik më të lartë, i cili është i pranishëm në takim.
2. Komisioni duhet të jetë në përbërje të plotë për mbajtjen e takimeve.
3. Komisioni nxjerr opinion në mënyrë unanime.
4. Komisioni mban takimet në objektin e Këshillit dhe të njëjtat janë të mbyllura për publikun.

Neni 13

Opinionet e Komisionit

1. Opinioni i Komisionit duhet të përmbajë:
 - 1.1. hyrjen;
 - 1.2. legjislacionin në fuqi;
 - 1.3. paraqitjen e përshkrimit të çështjes;
 - 1.4. përmbledhjen e shkurtër të kërkesës;
 - 1.5. faktet përkatëse në të cilat mbështetet opinioni;
 - 1.6. gjetjet dhe rekomandimet e Komisionit, si dhe
 - 1.7. arsyetimin e opinionit.
2. Opinionet e Komisionit duhet të jenë në harmoni me dispozitat e Kodit të Etikës, ligjet e aplikueshme, standardet ndërkombëtare, rregullat e përcaktuara dhe opinionet e mëparshme.
3. Opinioni i Komisionit i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe publikohet në uebfaqen zyrtare të Këshillit, në pajtim me ligjin dhe aktet e zbatueshme nënligjore.
4. Publikimi i opinionit bëhet në pajtim me Rregulloren për Qasjen në Dokumente Publike, ndërsa dosja e parashtruesit të kërkesës është konfidenciale.

Neni 14

Trajnimi i anëtarëve të Komisionit

Këshilli dhe Akademia e Drejtësisë do të organizojnë trajnime për anëtarët e Komisionit.

Neni 15
Dispozitat kalimtare

Përrjashtimisht nga dispozitat e nenit 6, paragrafit 10, mandati i kryetarit të Komisionit me rastin e themelimit të tij, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, është katër (4) vjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, më 26 qershor 2023


Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

